

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti Për Krimeve Të Rënda, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Ibadete Zullufi, në lëndën penale kundër të pandehurit S.V. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/Inr.170/2016 të dt.27.06.2016, pas shqyrtimit fillestar me datë 26.09.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

I pandehuri **S.V.**nga i ati Rr. dhe nëna B., e gjinisë H., i lindur me datë *data e lindjes...*, me vendbanim në fshatin D. e P., Komuna P., i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I pandehuri S.V. nga data e pacaktuar e deri me datën 29.02.2016, në shtëpinë e tij në fshatin D. e P., pa autorizim nga organi kompetent ka mbajtur në posedim armën: pushkë gjysmë automatike automatike, me bajonetë, e kalibrit 7.62mm, me nr. serik 148668 dhe 29 fishekë, të cilat janë konfiskuar nga ana e policisë. Me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,45,50,51,52,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së, e gjykon:

### DËNIM ME KUSHT

**Të pandehurit S.V. i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti , i cili nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej 2 (dy) vitesh.**

Obligohet i pandehuri qe te paguajë shpenzimet e procedure penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së konfiskohet:

Pushkë gjysmë automatike, me bajonetë, e kalibrit 7.62 mm, me numër serik 148668 si dhe 29 fishekë.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.170/2016, të datë 27.06.2016, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin S.V. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Me datë 26.09.2016, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë qështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I.nr.170/2016, të datë 27.06.2016, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykues pasi që u bind se i

pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri S.V. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, duke shprehur pendesën për veprën e kryer, njëherit ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë. Gjithashtu edhe prokurori i çështjes është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, me arsyetimin se pranimi i fajësisë ka mbështetje ligjore.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: Vërtetimi mbi marrjen e përkohshëm të gjësendeve, të datës 29.02.2016, si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi me kusht si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cila është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjenerale që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor konform nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**PKR. nr.385/16, datë 26.09.2016**

**Sekretarja Juridike:**  
**Ibadete Zullufi**

**Gjyqtari:**  
**Arben Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.